

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-zyrtar
Më 2.10.2013

Kryetari i Komunës, pasi shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës, për lejimin e shpalljes së tenderit për rregullimin e fushës sportive në ShMT "11 Marsi", mori këtë

KONKLuzion

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës, i datës 1.10.2013, për lejimin e rregullimit dhe shtrimit të fushës sportive me asfalt në Shkollën e Mesme Teknike "11 Marsi" në Prizren, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.

Projekti realizohet nga buxheti vetanak i shkollës.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-zyrtar
Më 2.10.2013

Kryetari i Komunës, pasi shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës, për lejimin e shpalljes së tenderit për vendosjen e sistemit të kamerave në ambientet e ShMT "11 Marsi", mori këtë

KONKLuzion

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës, i datës 1.10.2013, për lejimin e vendosjes së sistemit të kamerave për vëzhgim në ambientet e Shkollës së Mesme Teknike "11 Marsi" në Prizren, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.

Projekti realizohet nga buxheti vetanak i shkollës.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-zyrtar
Më 8.10.2013

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit për lejin e mjeteve financiare, me qëllim të përkrahjes së realizimit të koncertit për nder të Kurban Bajramit, kryetari i Komunës më 8 tetor 2013, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR LEJIMIN E MJETEVE NGA BUXHETI

Neni 1

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për lejin e mjeteve financiare me qëllim të përkrahjes së realizimit të koncertit muzikor - folklorik për nder të festës së Kurban Bajramit, që do të mbahet me 16 tetor 2013, kështu që, për këtë qëllim lejohen mjetet e nevojshme financiare.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve i Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Mulla



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-36900
Më 16.10.2013

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për lejimin e mjeteve shtesë për punimet shtesë në projektin “Ndërtimi i Shtëpisë së Kulturës në Hoqë të Qytetit”, kryetari i Komunës, më 16 tetor 2013, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR LEJIMIN E MJETEVE NGA BUXHETI

Neni 1

MIRATOHET propozimi i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, i datës 2.10.2013 për lejimin e mjeteve shtesë për punimet shtesë në projektin “Ndërtimi i Shtëpisë së Kulturës në Hoqë të Qytetit”, kështu që për realizimin e tërësishëm të këtij projekti lejohen punimet shtesë dhe mjete shtesë në lartësi deri në 10% nga kontrata nr. pro. 622-11-258-521.

Neni 2

Pagesa e shumës së lejuar nga neni 1 i këtij Vendimi do t’i bëhet, përfituesit të kontratës nr. pro. 622-11-258-521.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

